

A T K - T H E M E L I M I
PER KRIJIMIN E SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
" B A R D H I "

Sot, më datën, 05 Korrik 1996 (nëntëdhjet e gjashtë), unë, ortaku i vetëm, FATBARDH KASA, i biri i Kadriut dhe i Nafijes, i dt. 1965, lindur dhe banues ne Rrogozhine, Lagja Nr.1, P.88, Sh.1, Ap.7, shtetas shqiptar, v e n d o s a të krijoj SHOQERINE private në përputhje me legjislacionin në fuqi në Republikën e Shqipërisë e, veçanërisht të Ligjës Nr.7638 datë, 19.11.1992 "Për Shoqëritë Tregëtare", sipas kushteve që

v i j o j n ë :

Neni 1

1.1 Shoqërinë " B A R D H I " - SH.P.K. e krijoj sipas llojit - Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar.

Neni 2.

2.1 Shoqëria " B A R D H I " do të funksionojë për një periudhë kohe prej dhjet vjetësh, me të drejtë përsëritje edhe në të ardhmen.

Neni 3.

Emërtimi dhe qendra (selia)

3.1 Emërtimi i Shoqërisë është: Shoqëria " B A R D H I I " - Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar ose shkurt: "Shoqëria << BARDHI >> - Sh.P.K." që, në mjaft raste, në dokumentet e krijimit të saj do të shkruhet shkurt: "Shoqëria".

3.2 Qendra (selia) e Shoqërisë është:

Rrogozhine, Republika e Shqipërisë.

Tel: _____


Fax: _____

Neni 4.

OBJEKTI I VEPRIMTARISE

4.1 Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar " B A R D H I " ka per objekt ushtrimin e veprimtarise se saj te lire private ne fushen e:

*****-



- Sherbime publike: Pastrim mjedisesh, grumbullim, transportim dhe perpunim i mbeturinave;

- Organizim dhe kryerje e punimeve per gjelberim, zbukurim dhe mirembajtja e tyre;

- Sherbime funerale (prenotime dhe afishime, pajisje me materiale funerale, transportim i kufomave brenda dhe jashte vendit, hapje e mbyllje varri, pergatitje buqetash me lule dhe kurorash te ndryshme, kryerje zhvarrimi dhe rivarrimi sipas dispozitave ligjore ne fuqi, sherbime funebre, etj.);

- Sherbime per mirembajtje dhe riparim (mirembajtje dhe riparim varrezash, pastrim, sistemim dhe mirembajtje e tyre dhe e rrugëve dhe e rrugicave, gjelberim i varrezave, etj.);

- Sherbime dekori (pajisje me elemente zbukurimi te mjedisëve te qytetit, fshatit dhe te objekteve te ndryshme, pergatitje dhe vendosje tabelash, reklama, emertime, shenja rrugore, etj.);

- Organizim dhe kryerje e sherbimeve komunale (punime te ndryshme elektrike, hidraulike, patinime e bojatisje, vendosje pllakash, çbllokim kanalizimesh te ndryshme, etj.);

- Import - Eksport dhe tregetim me shumicë dhe me pakicë të mallrave të ndryshme industriale, bujqësore, blegtorale dhe ushqimore; artikuj elektroshtëpijake, makineri, aparatura dhe artikuj te ndryshem elektrike, elektronike dhe elektroteknike; materiale dhe sherbime ndërtimi, instalimi, për ngrohje, hidrosanitare, karburante dhe lubrifikante; turizëm dhe kamping; agjensi turistike, ndërmjetësimi dhe komisionerie; organizim dhe kryerje e shërbimeve të transportit tokësor, ajror dhe ujqor për mallra dhe pasagjerë, si dhe të serviseve për aparatura dhe automjete të ndryshme, etj. brenda dhe jashte vendit.

4.2 Shoqeria krijohet qe une ortaku i saj te suhtroj veprimtarine e lire private sipas objektit qe pasqyrohet ne Nenin 4 te ketij Akti dhe te perfitoj prej kesaj veprimtarie.

4.3 Shoqeria mund te marre pjese me aksione, me kuota ne shoqeri, filiale e perfaqesi te tjera qe kane te njejtin

%%%%%%%%%

objekt ose objekt të ngjashëm me të.

4.4

Shoqëria mund të krijojë filiale, qendra shërbimi e prodhimi, degë, zyra përfaqsimi, agjensi, dyqane, magazina etj. edhe në qytete të tjera të Republikës së Shqipërisë, në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.

4.5

Shoqëria mund të bëjë investime për ndërtimin e objekteve të ndryshme që i shërbejnë kryerjes së veprimtarisë së saj ndertimore, ekonomiko - tregëtare dhe financiare.

Neni 5.

Regjimi juridik.

5.1

Në të gjithë veprimtarinë e saj në teritorin e Republikës së Shqipërisë, Shoqëria udhëhiqet nga legjilacioni shqiptar në fuqi.

5.2

Të drejtat dhe detyrimet e Shoqërisë dhe të ortakut të saj përcaktohen më hollësisht në Statutin që i bashkëngjitet këtij Akti.

5.3

Shoqëria gëzon mbrojtje e sigurim të plotë në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.

5.4

Për evidentimin e veprimtarisë së Shoqërisë do te përdoren dispozitat ligjore në fuqi dhe kërkesat e përgjithshme të kontabilitetit, siç sqarohet më hollësisht në dispozitat përkatëse të Statutit të Shoqërisë.

5.5

Shoqëria gëzon afirmim ligjor që nga dita e regjistrimit të saj në Gjykatën e rrethit të Tiranës.

Neni 6.

Kapitali i Shoqërisë.

6.1

Kapitali bazë i Shoqërisë është: - 100.000 (njëqindmije) i depozituar në Bankën Kombetare Shqiptare, Dega e Rrogozhines.

6.2

Kapitali i Shoqërisë do të rritet krahas ecurisë së saj ekonomiko - financiare dhe tregëtare, si dhe të vendimeve që do të marr, unë, ortakut i vetëm i saj për ta rritur atë në të ardhmen.

6.3

Në rast vdekjeje të mua, ortakut, pasuria e Shoqërisë i



kalon trashëgimtarëve të mi ligjorë sipas legjislacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

Neni 7.

Drejtimi i Shoqërisë.

7.1 Fillimisht, Shoqëria do të udhëhiqet, administrohet dhe drejtohet nga unë, ortaku i vetëm dhe krijuesi i saj, Fatbardh Kasa, që do të kryej edhe detyrën e administratorit dhe të përfaqësuesit të Shoqërisë në marrëdhëniet me të tretët.

7.2 Krahas ecurisë së veprimtarisë së Shoqërisë, unë, krijuesi i saj, do të mendoj dhe do të vendos edhe për zgjerimin e organeve të ndryshme të drejtimit dhe të administrimit të Shoqërisë.

7.3 Për çdo çështje profesionale, si: për çështje juridike, ekonomike, teknike etj. Shoqëria do të angazhojë (emëroj) sipas rastit, juristë, ekonomistë, financierë, teknikë etj. në mënyrë të vijueshme ose të përkohëshme, duke punësuar specialistë sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 8.

Sigurimi i Shoqërisë.

8.1 Pasuria e Shoqërisë do të sigurohet në Institutin e Sigurimeve të Republikës së Shqipërisë, si dhe në institute të tjera shtetërore dhe private ekzistuese dhe ato që mund të krijohen në të ardhmen sipas legjislacionit në fuqi.

8.2 Masa e pasurisë që do sigurohet, si dhe koha e sigurimit të saj do të vendoset nga unë, ortaku i vetëm dhe administratori i saj.

Neni 9.

Afati i veprimtarisë së Shoqërisë.

9.1 Afati i veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë dhjetë vjet me të drejtë përsëritje edhe në të ardhmen.

Neni 10.

Likuidimi i Shoqërisë.

- 10.1 Rastet e likuidimit të Shoqërisë do të jenë ato që pasqyrohen në legjislacionin në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

Neni 11.

Dispozita të përgjithshme.

- 11.1 Ky Akt për themelimin e Shoqërisë ka si pjesë përbërëse të tij edhe Statutin e Shoqërisë, i cili i bashkëngjitet dhe depozitohet në organet përkatëse sipas dispozitave ligjore në fuqi.
- 11.2 Në rastet e likuidimit përfundimtar të Shoqërisë sipas legjislacionit në fuqi, pushon së vepruari edhe ky Akt Themelimi.
- 11.3 Adresa ligjore e Shoqërisë është: - Zyrat e Ndermarjes Komunale, Rrogozhinë, Republika e Shqipërisë.

Tel. _ _ _ _ _

Fax: _ _ _ _ _

- 11.3 Çdo ndryshim apo shtesë që mund t'i bëhet këtij Akti për themelimin e Shoqërisë, do të bëhet me shkrim, do të nënshkruhet nga unë ortaku i vetëm i saj dhe do të depozitohet si në dokumentet e Shoqërisë që mbahen në qendrën (selinë) e saj, ashtu edhe në Gjykatën e rrethit të Tiranës.

- 11.4 Ky Akt - Themelimi i Shoqërisë u përpilua në pesë kopje të barabarta nga unë, ortaku i vetëm dhe krijuesi i saj, FATBARDH KASA dhe nënshkruhet në Zyrën e Noterise, Tiranë, ku do të depozitohet kopja e parë, sot, më datën, __.07.1996 (Nëntëdhjetegjashtë).

ORTAKU I VETEM DHE ADMINISTRATORI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR "BARDHI"

/ FATBARDH KASA /

